



Australian Government



Pas vaksinimit tuaj me AstraZeneca kundër COVID-19

Përditësuar së fundi herë: 30 korrik 2021

Rreth vaksinës

Sot ju keni marrë **vaksinën AstraZeneca kundër COVID-19**.

Kjo vaksinë mund të parandalojë që njerëzit të sëmuren nga COVID-19. Vaksina Astrazeneca kundër COVID-19 nuk përmban asnjë virus të gjallë SARS-COV-2 (virusi që shkakton COVID-19), dhe nuk mund t'ju japë COVID-19. Ajo përmban kodin gjenetik për një pjesë të rëndësishme të virusit SARS-COV-2 të quajtur proteina spike që bartet në qelizat tuaja nga një virus 'bartës' i padëmshëm i të ftohtit (një adenovirus). Trupi juaj pastaj e krijon proteinën spike dhe e përdor atë për të mësuar të njohë dhe të luftojë kundër virusit SARS-COV-2. Adenovirusi është modifikuar në mënyrë që të mos përsëritet pasi të jetë brenda qelizave. Kjo do të thotë se nuk mund të përhapet në qeliza të tjera dhe të shkaktojë infeksion.

Çfarë duhet të pritni pas vaksinimit

Ashtu si edhe me çdo vaksinë, mund të keni disa efekte anësore pas marrjes së vaksinës kundër COVID-19.

Efektet **e zakonshme** anësore pas marrjes së **vaksinës AstraZeneca kundër COVID-19** përfshijnë:

- dhimbje, ënjtje, ndjeshmëri, skuqje ose kruajtje në vendin e injektimit
- lodhje
- dhimbje koke
- dhimbje të muskujve
- të përzier
- ethe dhe të dridhura
- ndjeheni i sëmurë
- dhimbje në nyje.

health.gov.au/covid19-vaccines-languages

After your AstraZeneca COVID-19 Vaccination - 14082021 - Albanian

Efekte anësore **më pak të zakonshme** pas marrjes së **vaksinës AstraZeneca kundër COVID-19** përfshijnë:

- fryrje limfatike të zgjeruara
- dhimbje në gjymtyrë
- marramendje
- oreks i zvogëluar
- dhimbje stomaku.

Këto efekte anësore zakonisht janë të buta. Ato ndodhin diku në dy të tretat e njerëzve që vaksinohen, kurse fillojnë një ditë pas vaksinimit dhe zakonisht largohen brenda një ose dy ditëve.

Disa njerëz do të kenë simptoma më të dukshme të ngjajshme me gripin nga ky vaksinim në krahasim me vaksinimet e tjera dhe mund të duhet pushim nga aktivitetet normale. Këto simptoma më të shpeshta janë pas dozës së parë në krahasim me dozën e dytë.

Nëse keni dhimbje në vendin e injektimit, ethe, dhimbje koke ose dhimbje trupore në ditën e 1-2 pas vaksinimit, mund të merrni paracetamol. Kjo ndihmon për të zvogëluar disa nga simptomat e mësipërme. Ju nuk keni nevojë të merrni paracetamol ose ibuprofen para vaksinimit. Nëse ka ënjtje në vendin e injektimit, mund të përdorni një kompresë të ftohtë.

Efekte **të rralla** anësore që janë raportuar pas marrjes së **vaksinës AstraZeneca kundër COVID-19** janë:

- Reaksion i rëndë alergjik (anafilaksi):
 - Anafilaksia pas vaksinimit me AstraZeneca kundër COVID-19 është shumë e rrallë. Shkalla në Australi duket e ngjajshme me vaksinat e tjera.
- Një gjendje shumë e rallë e që quhet trombozë me sindromën trombocitopeni (TTS), që përfshin mpiksjen e gjakut (trombozë) dhe nivele të ulëta të trombociteve (trombocitopeni):
 - Informacione nga Australia dhe nga jashtë vendi tregojnë se TTS është një gjendje e rrallë
 - Mpiksja e gjakut mund të ndodh në pjesë të ndryshme të trupit, përfshirë trurin (kjo quhet trombozë cerebrale venoze sinusale) dhe në abdomen (kjo quhet trombozë idiopatike e venës splankike). Niveli i ulët i trombociteve mund të shkakton gjakderdhje.
 - Simptomat e kësaj gjendjeje fillojnë nga 4 deri 42 ditë pas vaksinimit.
 - Njerëzit me këtë gjendje janë të sëmurë rëndë dhe kanë nevojë të shkojnë në spital. Kjo gjendje mund të çon në invaliditet afatgjatë, por edhe vdekje.
 - Më shumë informacione në lidhje me TTS mund të gjenden në [Fletën informuese të pacientëve për vaksinën AstraZeneca kundër COVID-19 dhe TTS](#).

Ju duhet të kërkonti kujdes mjekësor pas vaksinimit nëse:

- Ju mendoni se jeni duke përjetuar një reaksion alergjik. Telefononi 000 nëse përjetoni simptoma të rënda, të tilla si vështirësi në frymëmarrje, gulçim, rrahje të shpejtë të zemrës ose kolaps.
- Ju keni një efekt anësor të pritur të vaksinës që nuk është larguar edhe pas disa ditëve.
- Keni ndonjë nga simptomat në vijim, në veçanti diku nga dita e 4 deri në të 42 ditë pas vaksinimit:
 - Kokëdhembje që zgjat më shumë se 48 orë pas vaksinimit, apo paraqitet më vonë se 48 orë pas vaksinimit. Qetësues të thjeshtë mund të lehtësojnë kokëdhembjen fillimisht, por ajo prapë vazhdon

- të pamurit të turbullt
- plogështi në fytyrë apo gjymtyrë
- konfuzion apo krizë.
- gulçim
- dhimbje gjoksi
- dhimbje të vazhdueshme të abdomenit
- enjtje të këmbëve
- skuqje apo mavijosje nga gjilpëra por jo në vendin e injektimit e që nuk ka shpjegim.

Sigurohuni që t'i tregoni mjekut tuaj se kohët e fundit keni marrur vaskinë. Për simptomat që nuk janë urgjente, ju mund të vizitoni ofruesin tuaj të rregullt të kujdesit shëndetësor (zakonisht mjeku juaj familjar).

Monitorimi i sigurisë së vaksinës dhe raportimi i efekteve anësore

Ju mund të raportoni efekte anësore të dyshuara tek ofruesi juaj i vaksinimit ose profesionistë tjetër shëndetësorë. Ata pastaj do të bëjnë një raport formal në emrin tuaj në departamentin shëndetësor të shtetit ose territorit tuaj ose direkt në Administratën e Mallrave Terapeutike (TGA).

Nëse preferoni ta raportoni vetë, ju lutemi vizitoni faqen e internetit të TGA dhe ndiqni udhëzimet atë faqe: <https://www.tga.gov.au/reporting-suspected-side-effects-associated-covid-19-vaccine>.

Testimi për COVID-19 pas vaksinimit

Disa efekte anësore nga vaksinimi kundër COVID-19 mund të jenë të ngjashme me simptomat e COVID-19 (p.sh. ethe). Megjithatë, vaksina Astrazeneca kundër COVID-19 nuk përmban asnjë virus të gjallë SARS-COV-2 dhe nuk mund të shkaktojë COVID-19. Ju mund të mos keni nevojë të bëni test për COVID-19 ose të izoloheni:

- nëse zhvillonit simptoma të përgjithshme si ethe, dhimbje koke ose lodhje në dy ditët e para pas vaksinimit, dhe
- nëse jeni i sigurt që nuk keni simptoma të frymëmarrjes (p.sh. hundë që rrjedhe, kollitje, dhimbje e fytit, humbje e erës ose humbje e shijes).

Megjithatë, ju duhet të kontrolloni udhëzimet aktuale në shtetin/territorin tuaj për informacionet e fundit. Kjo këshillë mund të ndryshojë në rast të një shpërthimi të COVID-19 në zonën tuaj lokale. Ju ende mund të keni nevojë të bëni një test për COVID-19 nëse plotësoni kritere të tjera, për shembull nëse jeni një kontakt i ngushtë i një rasti të njohur me COVID-19. Nëse keni dyshim, kërkoni vlerësim mjekësor.

Mos harroni terminin tuaj të dytë

Është e rëndësishme që ju të merrni dy doza të vaksinës AstraZeneca kundër COVID-19, diku 12 javë larg njëra tjetrës. Shkurtimi i intervalit nga 12 javë në jo më pak se 4 javë në mes dozave mund të jetë e përshtatshme në rrethana të caktuara. Doza e dytë do t'ju jep mbrojtje më të mirë kundër COVID-19.

Si përdoren informacionet që jepni në terminin tuaj

Për informacione mbi mënyrën se si të dhënat tuaja personale janë mbledhura, ruajtura dhe përdoren vizitoni <https://www.health.gov.au/using-our-websites/privacy/privacy-notice-for-covid-19-vaccinations>